

BULETIN



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

TETOR – DHJETOR 2005

Buletin 3-mujor /Nr. 14

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID “CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT”

PASQYRA E PËRMBAJTJES

1. VËZHGIME

- 1.1 Respektimi i të drejtave të emigrantëve në pikat e kalim-kufirit me Greqinë
- 1.2 Respektimi i të drejtave të të paraburgosurve në komisarariatet e disa rretheve
- 1.3 Mision vëzhgimi për respektimin e të drejtave të të dënuarve në spitalin e burgut
- 1.4 Vëzhgime të respektimit të të drejtave të minoritetit rom në Shqipëri
- 1.5 Respektimi i të drejtave të punëtorëve në firmat private
- 1.6 Respektimi i të drejtave të qytetarëve në fusha të tjera të drejtave të njeriut

2. VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM EKSPERTIZE

2.1 Ofrim ekspertize ligjore

- 2.1.1 Ekspertizë ligjore në fushën e Strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”
- 2.1.2 Oponencë ligjore dhënë nga KSHH-ja për projekt rregullonin e sistemit të paraburgimit në shqipëri

2.2 Ngritja e kapaciteteve të administratës së burgjeve

2.2.1 Ngritje kapaciteteve ofruar administratës së burgjeve në kuadër të përmirësimit të sistemit të burgjeve

- Aktiviteti “Trajnim trajnerësh”
- Sesioni i parë i punës me personelin e burgut të Lezhës
- Sesioni i dytë i punës ofruar administratës së burgut të Lezhës

2.2.2 Takime këshillimore

3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

3.1 Veprimtari sensibilizuese dhe edukuese për publikun

- 3.1.1 “Ekspoze vlerash njerëzore” – Aktivitet në kuadër të ditës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut
- 3.2 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendase, të huaja dhe organizmat ndërkombëtarë
- 3.2.1 Takim me Ministrin e Drejtësisë dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve
- 3.3 Aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit

3.4 Misione vlerësimi dhe mbështetëse të punës së rrjetit të korrespondentëve

4. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJVE KORRIK – SHTATOR 2005

4.1 PUBLIKIME (STUDIME)

- 4.1.1 Publikimi “Sistemi i drejtësisë penale për të mitur në shqipëri” (Reflektime mbi të tashmen dhe të ardhmen e tij)”

4.2 RAPORTE

- 4.2.1 Raporti përfundimtar “Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje”
- 4.2.2 Raporti vjetor i KSHH-së, viti 2004
- 4.2.3 Raporti përfundimtar për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare, korrik 2005

4.3 BROSHURA – GUIDA – FLETËPALOSJE

- 4.3.1 Guida – KSHH në 15 vjet”
- 4.3.2 Libërth xhepi: Rregullat e sjelljes për punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve
- 4.3.3 Kalendarë sensibilizues 2006
- 4.3.4 Përmbledhje të deklaratave 2001 – 2005 të KSHH-së

5. TRYEZA DHE KONFERENCA

- 5.1 Përvjetori i KSHH-së
- 5.2 Konferenca kombëtare e Avokatit të popullit “Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”

6. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË

- a) Ankesat e qytetarëve
- b) Raste të verifikuara

7. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË

8. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHTETËRORE DHE ORGANIZATA

9. KSHH DHE MEDIA

10. NGRITJE KAPACITETESH

- 10.1 Ngritje kapaciteteve të KSHH-së nëpërmjet trajnimeve
- 10.2 Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme

1. VËZHGIME

1.1 Respektimi i të drejtave të emigrantëve në pikat e kalim-kufirit me Greqinë

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2005, korrespondentët e KShH-së dhe ekspertë lokalë të angazhuar nga KShH-ja, kanë vëzhguar respektimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë nga policia kufitare shqiptare dhe ajo e huaj, në Kapshticë, Kakavijë dhe Portin e Vlorës. Përveç intervistave me emigrantë, janë zhvilluar takime me komandatët e postave të kalim kufirit të Gjirokastrës dhe Korçës, me kapitenarinë dhe kreun e doganës të portit të Vlorës. Ndër çështjet që u vëzhguan ishin respektimi i të drejtave të emigrantëve, ekzistenca e rasteve të keqtrajtimit të tyre nga policia kufitare, cilësia e shërbimit, etj. Korrespondentët e KShH-së gjithashtu kanë mundësuar kontaktet me familjarët e emigrantëve shqiptarë të keqtrajtuar nga policia kufitare.

1.2 Respektimi i të drejtave të të parburgosurve në komisaritet e disa rretheve¹

Bazuar në ankesat e marra dhe sinjalizimet e medias, korrespondentët e KShH-së kanë bërë verifikime dhe vëzhgime në komisaritet: Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër, Fieri dhe në parburgimin e Vlorës. Korrespondentët kanë kontaktuar personat përgjegjës dhe personelin tjetër në komisaritate. Në varësi të problemeve të konstatuara, KShH-ja i ka adresuar çështjet institucioneve përkatëse. Korrespondentët e KShH-së, me kërkesë të të arrestuarve, kanë monitorur **3 seanca gjyqësore** lidhur me respektimin e të drejtave të personave të ndaluar për një proces të rregullt ligjor.

1.3 Mision vëzhgimi për respektimin e të drejtave të të dënuarve në spitalin e burgut

Në datën **13 Tetor 2005**, KShH kreu një mision vëzhgimi në Spitalin e Burgut në Tiranë. Me qëllim verifikimit e disa problemeve të konstatuara dhe për të parë zbatimin e rekomandimeve lidhur me trajtimin e personave të moshuar dhe sëmundje të pashërueshme.

Nga takimet dhe verifikimet rezultoi se në spitalin e burgut ishin marrë një konsideratë një sërë rekomandimesh të KShH-së, si: emërimi i një psikologu, rritja e numrit të kujdestarëve, transferimi i nënave me fëmijë institucionin nr. 325, etj.

Megjithatë end enuk është zgjidhur transferimi i të dënuarve, të sëmurë mendorë në institucione të specializuara, përmirësimi i kushteve të jetesës në këtë institucion si dhe problemi i të të sëmurëve stacionarë.

1.4 Vëzhgime i respektimit të të drejtave të minoritetit rom në Shqipëri

Zbatimi i strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom” ka qënë në fokusin e KShH-së. Gjatë *muajt korrik dhe tetor 2005*, korrespondentët e KShH-së kryen disa misione vëzhgimi në Fier, Korçë, Shkodër dhe Elbasan², për të parë nga afër zbatimin e strategjisë së romëve në fushën e arsimit. Takimet e zhvilluan me përfaqësues të shoqatave rome, të institucioneve të Prefekturave, Bashkive, komunave, në këto qytete.

¹ Vëzhgime në komisaritate janë kryer në kuadër të projektit “Së bashku për një shoqëri më demokratike ku respektohen të drejtat e njeriut”, mbështetur financiarisht nga Fondacioni SOROS

² Këto vëzhgime u mundësuan nga projekti “Së bashku për një shoqëri më demokratike, ku respektohen të drejtat e njeriut”, mbështetur financiarisht nga Fondacioni SOROS dhe projekti “Promovimi i të drejtave të minoriteteve dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar” ADI

Gjatë misionëve mbështetëse dhe vlerësuese të ndërmarra nga KShH-ja, Grupi i vlerësimit të rrjetit të korrespondentëve³, i është kushtuar një vemëndje të veçantë politikave të ndryshme për punësimin, arsimimin, strehimin e minoritetit rom.

1.5 Respektimi i të drejtave të punëtorëve në firmat private

Korrespondentët e KShH-së të qytetit të Vlorës dhe Gjirokastrës, gjatë muajve tetor - nëntor 2005, kanë kryer 2 misione vëzhgime në disa firma private për respektimin e të drejtave të punëtorëve. Bazuar në rekomandimet e korrespondentëve⁴ dhe një pyetësor i përgatitur më parë, u vëzhguan respektimi i të drejtave të punëtorëve në firmat private dhe përmirësimet e bëra. Në kuadër të vëzhgimeve, u kontaktua me qytetarë, administratorët e firmave private, organet lokale si: Inspektoriatet e punës, Drejtoritë e Shëndetit dhe kujdesit parësor, Drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, zyrave rajonale të punësimit, Bashkitë e qyteteve, etj.

1.6 Respektimi i të drejtave të qytetarëve në fusha të tjera të drejtave të njeriut

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2005, korrespondenti i rrethit të *Elbasanit* kreu një *vëzhgim në hipotekën e këtij qytetit*, në bazë të ankesave të marra nga qytetarët e Elbasanit. Objekti i ankesës së tyre kishte të bënte lidhur me zvarritjen e dhënies të dokumentave të pronësisë, për të cilën u morr takim për të përcjellë këtë ankesë dhe me drejtorin e institucionit të hipotekës në Elbasan.

Shkelja e të drejtave të njeriut në *fushën e mjedisit në qytetin e Elbasanit* vazhdon të mbetet shqetësim. Korrespondenti i KShH-së në këtë qytet ka marrë gjithmonë ankesa nga qytetarët lidhur me këtë shqetësim. Kësaj here ankesa erdhi nga operatorët që punojnë në firmat Kurum dhe fabrika e çimentos të cilat janë të vendosura në ambjentet e ish metalurgjikut. Ky problem është diskutuar me Prefekten e qytetit të Elbasanit si nga korrespondenti i KSHH-së në këtë rreth dhe gjatë takimit që anëtarë të KSHH-së dhe stafit kanë patur në këtë qytet.

Pas ankesave të disa qytetarëve, korrespondenti i Shkodrës ndërmorri një *vëzhgim në spitalin rajonal të Shkodrës* (dhjetor 2005) kryesisht në pavionin e dializës. Mosfunksionimi siç duhet i procesit të dializës shkaktonte një sërë problemesh për qytetarët, duke çenuar kështu të drejtën e jetës. Lidhur me këtë shqetësim korrespondenti i KShH-së mori takim me pacientë si dhe me mjekë të këtij spitali.

2. OFRIM EKSPERTIZË NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT DHE ZBATIMIT TË TIJ

2.1 Ekspertizë ligjore në fushën e Strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”

Në kuadër të një projekti operacional të Fondacionit Soros (OSFA), KShH-ja është angazhuar në monitorimin e Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi u monitorua zbatimi i strategjisë rreth përkatësisht në 5 fusha kryesore, arsim dhe edukim, trashëgimia kulturore dhe familjare, ekonomia dhe mbrojtja sociale, shëndetësia dhe infrastruktura si edhe drejtësia dhe administrata publike.

Për të mbledhur fakte dhe informacione, u angazhuan korrespondentët e KShH-së në rrethet: Tiranë, Fier, Korçë, Elbasan dhe Shkodër. Qëllimi i studimit është jo vetëm evidentimi masave të marra për zbatimin e strategjisë, proe dhe bërja e rekomandimeve konkrete për organet

³ Shih kreun 3.4 të këtij buletinin, Misione vlerësimi dhe mbështetje të rrjetit të korrespondentëve të zhvilluara gjatë muajve nëntor – dhjetor 2005

⁴ Botimi I KSHH-së, “Respektimi i të drejtave të qytetarëve në disa rrethe të vëndit, korrespondentët e KSHH-së”, shtëpia botuese Kristalina-KH, viti i botimit 2003

shtetërore. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka marrë përsipër edhe koordinimin e veprimtarive në projekt.

2.2 Oponencë ligjore për projekt rregulloren e sistemit të paraburgimit në Shqipëri

Në kuadër të nismës së ndërmarrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB), KShh-ja bëri objekt studimi dhe shprehu mendimet e tija lidhur me projekt rregulloren e sistemit të paraburgimit në Shqipëri. KShH-ja vlerëson përgatitjen e rregullores si një hap pozitiv dhe vuri re se ajo është hartuar bazuar në standartet europiane dhe në përputhje me aktet ndërkombëtare. Në datën 6 dhjetor 2005, KShH mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe paraqiti sugjerime dhe vërejtje për përmirësimin e mëtejshëm të projekt rregullores.

3.0 Ngritja kapacitetesh dhe veprimtari trajnuese

3.1 Ngritje kapacitetesh ofruar administratës së burgjeve në kuadër të përmirësimit të sistemit të burgjeve

3.1.1 Aktiviteti “Trajnim trajnerësh”⁵

Nga datat 31 Tetor - 2 Nëntor 2005, KShH-ja organizoi aktivitetin “Trajnim trajnerësh”. Qëllimi i tij ishte krijimi i një grupi trajnerësh shqiptarë që do të trajnojnë administratën e burgjeve shqiptare, ndërtimi i një programi me temat: komunikim, kodi i sjelljes dhe të drejtat dhe detyrimet e personave të privuar nga liria.

Në këtë grup merrnin pjesë 12 specialistë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nga Qendra e Trajnimit të Administratës së Burgjeve dhe nga burgje të ndryshme që i përkisnin sektorëve të ndryshëm të tillë si nga sektori i sigurisë, edukimit, sektori ligjor etj. Trajnimi u krye nga tre ekspertë të huaj me përvojë në fushën e sistemit penitenciar si edhe në trajnimin e administratës së burgjeve përkatësisht z. Jan van den Brand⁶, z. Stef van de Lande⁷, dhe znj. Monique Lejenue⁸. Trajnimi ishte në nivelin teorik dhe atë praktik. Pjesëmarrësit punuan në grupe pune lidhur me temat e programit mësimor si dhe organizuan një model trajnimi të një teme të caktuar nga programi mësimor.

Pjesëmarrësit e vlerësuan trajnimin shumë të rëndësishëm dhe me vlera praktike në përputhje me nevojat dhe realitetin që ekziston në sistemin penitenciar në Shqipëri. Gjithashtu, pjesëmarrësit vlerësuan përfshirjen aktive të tyre në këtë trajnim në dhënien e konkluzioneve dhe mendimeve për zgjidhjen e situatave të ndryshme në punën e tyre të përditshme.

Në përfundim të këtij aktiviteti pjesëmarrësit u paisën me çertifikatat përkatëse.

3.1.2 Sesion i parë i punës me personelin e burgut të Lezhës⁹

⁵ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të fazës së dytë të zbatimit të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri- monitorimi i respektimit të të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe njohja e të drejtave të njeriut dhe ligjeve në këtë fushë” mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

⁶ Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë në Agjencinë Kombëtare Hollandeze të institucioneve të Riedukimit si edhe në të njëjtën kohë ekspert i Këshillit të Europës për Europën Qendrore dhe Lindore

⁷ Psikolog në sistemin penitenciar në Hollandë

⁸ Drejtore e Qendës për Menaxhim dhe Organizim ELVE e specializuar njëkohësisht për trajnimin e administratës së institucioneve penitenciare.

⁹ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KShH-së “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri- Monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit si dhe rritja e ndërgjegjësimit të administratës

Në kuadër të rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit dhe njohjes me të drejtat e njeriut dhe zbatimit të ligjeve nga administrata e burgjeve, në datat 6 dhe 7 Tetor 2005, KShH-ja organizoi sesionin e parë të punës me stafin e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të burgut të Lezhës. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, përgjegjës për trajtimin e të dënuarve dhe trajnimin e administratës së burgjeve. Eksperti i huaj, z. Jan van den Brand, ofroi ekspertizën e tij.

Duke qënë një administratë e re, çështjet e përzgjedhura për t'u trajtuar në këtë sesion ishin: mirëmenaxhimi i institucioneve penitenciare, misioni dhe vizionin e një burgu lokal, procesi i ndryshimit të mentaliteteve në drejtimin e burgjeve parë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, çështje të mekanizimit të kërkesë-ankesës në një institucion lokal si dhe se si mund të funksionojë ky mekanizëm brenda strukturave shtetërore.

Në këtë sesion u soll përvoja hollandeze lidhur me kriteret dhe kërkesat për përzgjedhjen dhe trajnimin e administratës së burgjeve.

Një element pozitiv që karakterizoi të gjithë këtë sesion pune ishte motivacioni i pjesëmarrësve për të mësuar gjëra të reja lidhur me punën e tyre të përditshme, i cili shënon një fillim premtues për punën në vazhdim.

3.1.3 Sesioni i dytë të punës ofruar administratës së burgut të Lezhës¹⁰

Në datën 27 Dhjetor 2005, KSHH organizoi sesionin e dytë të punës me stafin e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të burgut të Lezhës. Në këtë sesion ofroi ekspertizën e tij eksperti i huaj Z. Jan van den Brand¹¹.

Metodologjia e përdorur në këtë sesion ishte teknika pjesëmarrëse, ku konceptet teorike ishin të ndërlidhura me praktikën. Pjesëmarrësit prezantuan sfidat e tyre, çështjet kryesore që i shqetësonin dhe realitetin në burg si edhe mënyrën e përmirësimit të kësaj situate në të ardhmen.

Sesioni i punës u përqëndrua në disa çështje të rëndësishme të lidhura ngushtë me parimet dhe modelet e praktikave të mira që bëjnë të mundur realizimin e sigurisë, qetësisë dhe rregullit në një burg. Konkretisht u përqëndrua në përkufizimin e koncepteve bazë të cilat kishin si referencë artikujt e shkruar nga profesionistë ndërkombëtarë, përmirësimin e mënyrave të komunikimit dhe të bashkëpunimit për garantimin e një trajtimi human dhe të drejtë për personat e privuar nga liria, përvojat e vendeve të ndryshme, etj

Një tjetër temë e rëndësishme ishte mundësia që iu dha pjesëmarrësve për të punuar së bashku mbi një vlerësim shumë të rëndësishëm lidhur me mangësitë dhe sfidat që përballen në këtë institucion të veçantë riedukimi.

Çdo sektor prezantoi çështjet që më pas iu bënë prezente Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nëpërmjet një letre të hartuar nga Z. Jan van den Brand. Kjo ÷ të shërbejë si një instrument presioni pozitiv dhe lobim ndaj strukturave që hartojnë politika dhe marrin vendime në sistemin e burgjeve shqiptare me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të situatës dhe të kushteve në burgun e Lezhës për ta bërë atë një burg të sigurt dhe të qetë.

3.3 Takime këshillimore

publike dhe njohja e tyre me të drejtave e njeriut si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

¹⁰ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KShH-së "Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri-Monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit si dhe rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike dhe njohja e tyre me të drejtave e njeriut si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë", i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

¹¹ Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë në Agjencinë Kombëtare Hollandeze të institucioneve të Riedukimit si edhe ekspert i Këshillit të Europës për Europën Qendrore dhe Lindore.

Gjatë periudhës objekt raportimi, KShH ka realizuar disa takime këshillimore me të dënuar që vuajnë dënimin në institucionet e riedukimit të Rrogozhinës, Peqinit, Kosovës, Lezhës, Burrel dhe të Tepelenë. Qëllimi i tyre ishte dhënia e konsulencës ligjore falas dhe njohja e të dënuarve me të drejtat dhe detyrat e tyre të përcaktuara në ligj.

Çështjet ligjore të trajtuara me të dënuarit u përzgjedhën në bazë të nevojave paraprake të prezantuara nga personeli i këtyre institucioneve dhe nga kërkesat e vetë të dënuarve. Ndihma ligjore iu dha të dënuarve në grup dhe në mënyrë individuale.

Takimet këshillimore janë kryer nga një grup juristësh të KShH-së me përvojë në fushën penale. Në të gjitha takimet këshillimore grupi i juristëve mori takim me drejtuesit e institucioneve të riedukimit.

Në përfundim të takimeve këshillimore, nëpërmjet një letre të dërguar Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si edhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë KshH-ja adresoi disa rekomandime dhe sugjerime konkrete lidhur me përmirësimin e situatës së të drejtave të të dënuarve në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës në këto burgje, përmirësimin e legjislacionit përkatës dhe praktikës dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale në administratën në këto institucione.

4. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

4.1 “Ekspoze vlerash njerëzore”

Më 10 Dhjetor 2005, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve organizoi aktivitetin me temë “Ekspoze vlerash njerëzore”. Aktiviteti synonte vlerësimin e vlerave dhe të aftësive të të paraburgosurve dhe të të dënuarve të cilat u pasqyruan me punimet më të mira të të dënuarve (punime artizanale, punime me dorë, në pikturë dhe në poezi).

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, sikurse edhe një vit më parë, e çmoi me vend të kontribuonte në këtë aktivitet duke ofruar çmime simbolike, shoqëruar me certifikatë për 4 krijimet më të mira të realizuar nga të paraburgosur dhe të dënuar të ndryshëm. Nëpërmjet kësaj veprimtarie KShH-ja synoi të mbështetë të vlerësojë dinjitetin njerëzor dhe vlerat humane.

Aktiviteti u ndoq me interes nga media e shkruar dhe ajo elektronike. Në këtë kuadër, znj. Edlira Papavangjeli, Koordinatorë Programesh në KShH u ftua në një emision-debat me temë “Artistë Vrasës” në kanal televiziv A1, ku u diskutua rreth rëndësisë që kanë veprimtari të tilla krijuese në drejtim të riintegritit të të dënuarve në shoqëri.

4.2 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendase, të huaja dhe organizmat ndërkombëtarë

Në datën 14 Tetor 2005, përfaqësues të KShH-së morën takime me z. Aldo Bumçi, Ministër i Drejtësisë, dhe z. Sajmir Shehri, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve. Gjatë këtyre takimeve, u prezantuan veprimtarinë e KShH-së në fusha të tilla si: reformat ligjore në fushën penale, drejtësia për të miturit, Masterplanin vendet e paraburgimit, Plani i Veprimit i Ministrisë së Drejtësisë, Rregullorja e Brendshme e Institutit të Vuajtjes së Dënimit, Peqin dhe Kodi i Sjelljes për administratën e burgjeve etj.

KShH-ja bëri presentë veprimtarinë e tij gjatë këtyre viteve për përmirësimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, rritjen e kapaciteteve të administratës së burgjeve dhe veprimtaritë lobuese në fusha të tilla si: shërbimi përbarimor dhe ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatës, shërbimi avokator falas e të tjera çështje të reformës në drejtësi.

Gjatë takimeve u bënë të njohura veprimtaritë e KShH-ja dhe mundësitë e bashkëpunimit për periudhën në vazhdim.

Përfaqësuesit ndanin të njëjtat qëndrime në lidhje me problemet dhe sfidat që ka përpara drejtësia shqiptare në fushat e lartpërmendura dhe për prioritetet në këtë fushë.

KShH-ja gjeti mbështetjen e Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në realizimin e veprimtarive të tij, sidomos ato në fushën e rritjes së kapaciteteve të administratës së burgjeve etj.

Në këtë takim morrën pjesë znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së dhe znj. Edlira Papavangjeli, kordinatore e programeve në kShH.

4.3 Aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit

Në kuadër të Konsortiumit Ndërkombëtar, anëtar i të cilit është KShH-ja, me datë 5 dhjetor 2005 u zhvillua mbledhja e radhës e këtij Konsortiumi ku mori pjesë edhe KShH-ja. Në këtë takim u diskutua lidhur me çështje të tilla si: mbrojtja e dëshmitarit dhe organizimi i punës në këtë drejtim.

4.4 Misione vlerësimi dhe mbështetëse të punës së rrjetit të korrespondentëve

Përfaqësues të KShH-së, anëtarë të bordit dhe staf i projektit, zhvilluan 3 misione mbështetëse dhe vlerësimi të rrjetit të korrespondentëve në rrethet Fier, Elbasan dhe Shkodër (Nëntor – dhjetor 2005). Qëllimi i tyre ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të njeriut në këto rrethe, i punës të korrespondentëve të KShH-së dhe një mbështetje për ta.

U zhvilluan takime me autoritetet përkatëse lokale dhe OJF-të lokale të cilat kontribuan në forcimin e kontakteve të KShH-së me aktorë lokalë si: kryetarët e gjykatave, prokurorët e rretheve, me shefat e komisarivateve, drejtorët e policisë së qarqeve, kryetarët e bashkive të rretheve, prefektët e prefekturave, përfaqësues të shoqërisë civile lokale dhe me stafin mbështetës të këtyre institucioneve.

Në realizimin e këtyre misionëve, korrespondentët dhanë një kontribut të veçantë.

5. PUBLIKIMET E KSHH-SË

5.1 Studimi “Sistemi i drejtësisë penale për të mitur në shqipëri” (Reflektime mbi të tashmen dhe të ardhmen e tij)¹²”

Publikimi synon informimin e perosanve të interesuar, të autoriteteve shtetërore, shoqërisë civile dhe publikut lidhur me disa aspekte të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri, problematikën që paraqet ai në praktikë dhe përpjekjet që po bëhen për të përmirësuar efektivitetin e tij.

Në këtë studim, trajtohet organizimi i sistemit të drejtësisë penale për të mitur, legjislacionit në fuqi dhe jepen mendime lidhur me ndryshimet e propozuara nga Ministria e Drejtësisë, lidhur me probleme të tilla si: gjykimi i të miturve nga seksione ose gjykata të veçanta, ofrimi i një shërbimi ligjor falas të specializuar, aplikimi i dënimeve alternative për të miturit, përfshirja e psikologut dhe punonjësit social në një proces penal, etj.

Gjithashtu në këtë publikim janë paraqitur rekomandime dhe përfundime për aspekte të veçanta të sistemit të drejtësisë penale për të mitur.

¹² Ky publikim është botuar në dhjetor 2005, në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut nëpërmjet monitorimit, studimit, lobimit dhe mbrojtjes për një respektim më të mirë të parimeve Kushtetuese”, Komiteti Suedez i Helsinkit

5.2 Raporti përfundimtar “Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje”¹³

Raporti përmban përfundimet e vëzhgimeve të realizuara nga KSHH të disa vende paraburgimi dhe burgje, sidomos në fusha të tilla si: respektimi i të drejtave të personave të dënuar dhe të paraburgosur, zbatimi i ligjit, identifikimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut, etj. Punimi përmban rekomandime për disa nga çështjet më të rëndësishme të pranishme në këtë fushë.

Publikimi paraqet interes për institucionet vendimmarrëse dhe ekzekutive, shoqërinë civile dhe publikut e interesuar në këtë fushë.

5.3 Raporti vjetor i KSHH-së, viti 2004¹⁴

Në kuadër të transparencës dhe rritjes së aksesit të publikut në veprimtarinë e KSHH-së u botua raporti vjetor 2004 i cili pasqyron gjithë veprimtarinë e organizatës. Raporti është botuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.

5.4 Raporti përfundimtar për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare, korrik 2005¹⁵

Me përfundimin e procesit zgjedhor, KShH publikoi raportin përfundimtar për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005, i cili është botuar online në faqen tonë të internetit në versionin shqip.

Në këtë raport trajtohen përfundimet e KShH-së lidhur me probleme të vëzhguara gjatë periudhës parazgjedhore, si: lista e zgjedhësve, ngritja e komisioneve zonale, e qendrave të votimit, ngritja e komisioneve të qendrave të votimit, ngritja e grupeve të numërimit, trajnimin e komisionerëve dhe fushatën elektorale dhe gjatë procesin zgjedhor duke përfshirë procesin e votimit dhe problematikën e saj si dhe procesin e numërimit të votave dhe problematika e paraqitur.

Gjithashtu në këtë raport janë paraqitur edhe disa rekomandime për të përmirësuar punën në të ardhmen¹⁶.

5.5 BROSHURA – GUIDA - FLETËPALOSJE

▪ Publikimi “Guida – KSHH në 15 vjet”¹⁷

Publikimi prezanton veprimtarinë e KShH-së në 15 vjet (1990 – 2005), misionin, strategjinë dhe vizionin i KSHH-së; fushat e veprimtarisë së KShH-së në vite; tregues të punës të tij, publikimet e KSHH-së në vite, organizatat bashkëpunuese të huaja dhe vendase, mbështetësit kryesorë të tij, stafin dhe strukturën organizative të KSHH dhe rrjetin e korrespondentëve.

Publikimi është botuar në versionin shqip dhe anglisht, dhe mund të gjenden edhe në CD.

¹³ Ky publikim u botua në dhjetor 2005, në kuadër të projektit “Refoma e burgjeve dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

¹⁴ Një kopje të këtij publikimi e gjeni bashkangjitur në Aneksin Nr.6

¹⁵ Botimi I këtij raporti u mbështet financiarisht nga CORDAID

¹⁶ Për më shumë shih faqen tonë të internetit www.ahc.org.al

¹⁷ Ky publikim u mbështet financiarisht nga CORDAID, SOROS, Komiteti Suedez I Helsinkit dhe Komiteti Norvegjez i Helsinkit

- **Libërth xhepi: Rregullat e sjelljes për punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve**

Krahas rolit të KShH-së në draftimin e rregullave të sjelljes për punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe burgjeve, Kshh-ja mundësoi botimin e këtyre rregullave

Rregullat e sjelljes janë miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, Nr. 3052/1, datë 25.5.2005 dhe synojnë t'u vijnë në ndihmë të gjithë personelit në institucionet penitenciare, personave në kontakt me këto institucione për njohjen e këtyre rregullave si dhe shoqërisë civile.

- **Kalendarë sensibilizues 2006**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka përgatitur **2 tipe të ndryshme kalendarësh** për vitin 2006. Këto kalendarë i drejtohen të gjithë qytetarëve të drejtat e të cilëve shkelen nga organet e policisë, administrata në burgje, apo nga administrata publike. Këta persona për shkeljet e të drejtave të tyre mund t'i drejtohen KShH-së. Gjithashtu, një tjetër mesazh që jepet në këta kalendarë i drejtohet qytetarëve të ndaluar ose të arrestuar në flagrancë.

- **Përmbledhje të deklaratave 2001 – 2005 të KShH-së**

Në kuadër të 15 vjetorit të krijimit të KShH-së, u përgatitën disa kopje me përmbledhje të deklaratave të KShH-së nga periudha 2001 – 2005 si dhe të buletinëve të tij si vazhdimësi e traditës së KShH-së ndër vite. Nëpërmjet këtyre përmbledhjeve paraqitet situata e të drejtave të njeriut sipas këndvështrimit të KShH-së. Këto përmbledhje do të jenë një ndihmë për të gjithë organizatat shqiptare dhe të huaja, studiuesit që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut për të vlerësuar situatën e të drejtave të njeriut gjatë kësaj periudhe.

6 TRYEZA DHE KONFERENCA

6.1 KShH-ja në vite -15 vjetori I KShH-së¹⁸

Me rastin e 15 vjetorit të KShH-së, më datë 19 dhjetor 2005, u organizua një veprimtari ku moren pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, qëndrore dhe lokale, të OJF-ve vendase dhe ndërkombëtare, përfaqësues të ambasadave të huaja dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, përfaqësues të medias së shkruar dhe elektronike, anëtarësia, bordi, korrespondentët, personat e mëparshëm të angazhuar në KShH, vëzhgues dhe stafi i tij.

Nëpërmjet fotografive dhe materialeve të tjera ilustruese, pjesëmarrësit patën mundësi të njihnin më mirë veprimtarinë e KShH-së në vite. Më këtë rast, u publikua guida “15 vjet KShH”. Gjatë kësaj ceremonisë qëndruan të hapura, dy kënde me publikime të KShH-së, një me publikime të cilat iu shpërndanë pjesëmarrësve, si dhe këndi tjetër ekspozimi i titujve të shumtë të publikimeve që përbëjnë njëkohësisht dhe arkivin e publikimeve të KShH-së.

6.2 Konferenca kombëtare e Avokatit të Popullit “Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”.

Në datën 15 dhjetor 2005, institucioni i Avokatit të Popullit, me mbështetjen e UNICEF-it dhe Save the Children, organizoi konferencën kombëtare “Të gjithë së bashku në mbrojtje të të

¹⁸ Kjo veprimtari u mbështet financiarisht nga 4 mbështetësit kryesorë të KShH-së në vite, CORDAID, Fondacioni SOROS, Komiteti Suedez i Helsinkit dhe Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

drejtave të fëmijëve”. Në këtë konferencë morën pjesë nëpërmjet kontributit të tyre, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe përfaqësues të disa organizatave vendase që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

KShH-ja u prezantua me një referat për sistemin e drejtësisë për të miturit, respektimin e të drejtave të të miturve që ndodhen në institucionet e paraburgimit dhe burgjet, në kontakt me organet e drejtësisë, etj..


Nga përfundim të konferencës, pjesëmarrësit dolën me rekomandime lidhur me përmirësimin e situatës të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

7 SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2005, KSHH-ja ka trajtuar **168 ankesa dhe letra** me objekt të ndryshme si: vendime të padrejta gjyqësore dhe kërkesa për rishikim të tyre, shkelje të të drejtave gjatë proceseve gjyqësore, kërkesa për transferime, kërkesa për këshillime ligjore dhe për avokat falas, ushtrimi i dhunës në burgje, kushte të këqija në burgje, kërkesa për ekstradim në burgjet shqiptare, ankesa nga emigrantët shqiptarë të dënuar nga organet e drejtësisë greke, për korrupsion, etj. Një numër ankesash ka ardhur nga personat e paraburgosur ose të dënuar me vendim të formës së prerë.

Ankesat janë marrë nga takimet në zyrë me juristë të KSHH-së, nëpërmjet letrave drejtuar në adresën e KShH-së, këshillimeve ligjore, etj.

KShH-ja ka sqaruar ankuesit për problematikën e shfaqur duke dhënë rekomandimet përkatëse si dhe u ka kërkuar autoriteteve shtetërore të ndërhyjë për të zgjidhur çështjet konkrete. *Si më poshtë ndiqni paraqitjen grafike të ankesave:*



8. Raste të verifikuara nga KSHH-ja

Përveç trajtimit të letrave dhe ankesave të qytetarëve, KShH ka verifikuar raste, në të cilat pretendohet se ka patur shkelje flagrante të drejtave të njeriut.

- Në datën **24 Tetor 2005**, në bazë të sinjalizimeve nga media e shkruar, KShH-ja realizoi një mision verifikimi në burgun Nr. 302 në Tiranë lidhur me rastin e tentativës për vetvrasje të një të dënuari për shkak të mohimit të ushtrimit të riteve fetare. Pas verifikimve, kontaktimit me personin dhe me drejtuesin e institucionit konstatoi se problemi ishte vonesa në marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Apelit e cila shkaktonte mbajtjen padrejtësisht të personave në paraburgim.

- Në datën **10 Nëntor 2006**, në bazë të një sinjalizimi të marrë, KShH realizoi një mision verifikimi në burgun e Lezhës rreth një incidenti të dhunshëm të ndodhur ndërmjet disa të dënuarve të këtij institucioni dhe personelit të shërbimit. U morën kontakte të drejtpërdrejta me të dënuarit e përfshirë në ngjarje dhe me drejtorin e institucionin dhe personelin e burgut. Për normalizimin e situatës dhe rivendosjen e qetësisë në burg krahas drejtorisë së institucionit kishte ndërhyrë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e cila kishte marrë masat konkrete.

Nga kontaktet e marra në këtë institucion, KShH-ja konstatoi edhe probleme të tjera si: mungesa e theksuar e energjisë elektrike, mungesa e ujit, gjendja shumë e keqe e tualeteve dhe e dusheve të cilat ndikonin në kushtet higjieno-sanitare të burgut dhe në veçanti të të dënuarve.

- Në datën **24 Nëntor 2005**, për verifikimin e grevës tre-ditore të urisë së disa të dënuarve në burgun nr. 302, KShH ndërmori një verifikim në këtë institucion. Nga takimet me të dënuarit e përfshirë në grevën e urisë si edhe me drejtuesit e këtij institucioni rezultoi se shkaqet kryesore të saj ishin përmirësimi i kushteve të jetesës në burg, kërkesa për komunikime me të shpeshta me familjarët e tyre si edhe zgjerimi i të drejtave të tyre në një nivel të barabartë me të drejtat e të dënuarve.

Të paraburgosurit ankoreshin për zvarritje të proceseve gjyqësore, mosbesim ndaj avokatëve të caktuar kryesisht si edhe për vonesat në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë e cila shkaktonte vonesa në transferimin e të dënuarve në burgje.

- Në datën **24 Nëntor 2005**, në bazë të një numri të konsiderueshëm ankesash nga të dënuar, KShH kreu një mision verifikimi në burgun e Peqinit. Këto ankesa vinin nga një grup personash të dënuar nga gjykatat greke dhe që tashmë vuajnë dënimin në burgun e Peqinit. Nga takimet me të dënuar rezultoi se objekt i përbashkët i ankesave të tyre ishte kërkesa për të njohur uljen e dënimit sipas kushteve ligjore, kërkesat për lirim para kohe me kusht dhe denoncimi i korrupsionit dhe abuzimit me ligjin nga gjykatat shqiptare.

Për këtë qëllim, KShH-ja i drejtoi një letër Minsitrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit dhe Zyrës për Mbrojtjen e Qytetarëve për përmirësimin e situatës.

- Në datën **23 Dhjetor 2005**, KShH në bazë të disa sinjalizimeve telefonike ndërmori një mision verifikimi në burgun e Peqinit, objekt i së cilës ishte pretendimi për keqtrajtimin e disa të dënuarve të këtij institucioni nga ana e personelit të shërbimit. Pavarësisht nga masat e marra, KShH-ja nuk arriti të kryente verifikimin e pretendimeve të të dënuarve për arsye sigurie, meqënëse situata në rregjim ishte mjaft konfliktuale sipas të dhënave të marra nga drejtuesit e burgut të Peqinit.

KShH i drejtoi një letër Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për verifikimin e situatës konkrete dhe për marrjen e masave të nevojshme. KShH sinjalizoi dhe Avokatin e Popullit për verifikimin e rastit konkret.

- Në **nëntor 2005**, në adresë të korrespondentit të KShH-së në Elbasan, erdhi një ankesë nga një grup banorësh të zonës së Letanit (Elbasan). Objekti i ankesës së tyre ishte mosmarrja e certifikatave të pronësisë pavarësisht nga disponimi i dokumentacionit të pronësisë. Për verifikimin

e kësaj ankese u morën takime me banorët e kësaj zone si dhe ju përcoll ky shqetësim kryetarit të kësaj komune.

9. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2005, KShH ka reaguar nëpërmjet **7 deklaratave publike** të cilat kanë sjellë jehonë e disa problemeve kryesore që shqetësojnë opinionin shoqëror dhe që kanë të bëjnë me: lirinë e shtypit dhe të medias, krizën energjetike, luftën kundër ksenofobisë dhe racizmit, rimbursimin e barnave për pensionistët dhe invalidët, bllokimin e punimeve në disa nga rrugët kryesore të Tiranës, dhunimi i gazetarëve, etj¹⁹.

10. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHTETËRORE DHE ORGANIZATA

KShH si një organizatë oponente konstruktive e qeverisë ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet shtetërore. Korrespondenca ka konsistuar kryesisht në zgjidhjen e ankesave të ardhura në adresë të KShH-së, në paraqitjen e problematikës të dalë nga vëzhgimi, dhënien e rekomandimeve të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme ligjore dhe praktike, etj.,

Çështjet për të cilat ka patur komunikim me institucione si Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Arsimit janë: monitorimi i strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom në aspektin arsimor, vëzhgime në pikën e kalim kufirit Kapshticë, etj. Gjithashtu KShH ka patur një komunikim me këto institucione dhe në ofrimin e ekspertizës për reformën zgjedhore, mbi të drejtat e personave të ekstraduar nga Greqia, etj.

11. KSHH DHE MEDIA

Gjatë kësaj periudhe, aktivitetet e KShH-së janë paraqitur nga media të ndryshme elektronike dhe të shkruar, të cilat kanë ndihmuar në sensibilizimin e mbarë opinionit publik lidhur me çështje të ndryshme. Ato janë pasqyruar 13 herë në median e shkruar dhe elektronike gjatë këtij 3-mujori.

Shkrime dhe opinione të dhëna nga stafi i KShH-së në media numërohen rreth 16, ndër të cilat 3 janë emisione televizive në të cilat KShH ka qënë i ftuar. Në këto shkrime, intervista dhe emisione KShH është shprehur për çështje të ndryshme si reformën zgjedhore, situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri, çështje kushtetuese, minoritetet, emigrantët, të dënuarit dhe të paraburgosurit, etj.,

12. NGRITJE KAPACITETESH TË KSHH-SË

▪ Trajnimi “Për Konventën Evropiane të të drejtave të njeriut”

Në datat 20-21 Tetor 2005, Këshilli i Evropës organizoi një trajnimi për Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, procedurën para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasbourg, procedurat që duhen ndjekur nga avokatët për të dërguar një çështje në këtë Gjykatë, etj.

Nga KShH-ja morën pjesë në trajnim, Klesta Alikaj, juriste/as administrative dhe Etilda Saliu, juriste/Koordinatorë projekti në KShH.

¹⁹ Për më gjerë shih aneksin nr. 1

- **Trajnim “Menaxhim projekti”²⁰**

Gjatë periudhës 3-5 Nëntor 2005, Ersida Sefa, juriste. Assitemte projekti praën KShH-së mori pjesë në trajnimin me temë “Menaxhim projekti”, organizuar nga NET (Netëork for Exchange and Training) Në këtë trajnim u trajtuan çështje të rëndësishme të cilat përfshinin ciklin nga planifikimi deri në vlerësimin e një projekti. Trajnimi u organizua në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit të KSHH-së.

- **Trajnim “Menaxhim financiar për jofinancierë”²¹**

Në datat 7-9 nëntor 2005, znj.Vasilika Hysi, Drejtore Ekzekutive dhe znj. Edlira Papavangjeli, koordinatorë programesh pranë KShH-së morën pjesë në trajnimin “Menaxhim financiar për jofinancierë”, organizuar nga NET (Netëork for Exchange and training), në të cilin u trajtuan disa nga konceptet bazë të menaxhimit financiar të organizatave.

- **Trajnimiti “Menaxhimi financiar”²²**

Në datat 14 – 18 nëntor 2005, znj. Katerina Sherko, financiare pranë KSHH-së mori pjesë në trajnimin me temë “Menaxhim financiar”, organizuar nga NET (Netëork for Exchange and training), në të cilën zinin vënd temat specifike dhe profesionale për menaxhimin financiar në një organizatë.

- **Trajnim rajonal “Aksesi në drejtësi si dhe reforma në procesin e shërbimit avokator”**

Komiteti Suedez i Helsinkit në bashkëpunim me Public Interest Laë Initiative në datat 11 – 12 Nëntor 2005, në Budva, Mali i zi, organizuan trajnimin rajonal për aksesin në drejtësi si dhe reformën në procesin e shërbimit avokator falas. Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe përfaqësues të KShH-së. Pjesëmarrës nga KShH ishin juriste/Koordinatorë projekti dhe Alma Tafani, juriste në projektin që KShH-já zbaton ne burgje.

- **Trajnimiti rajonal „Gjykata Ndërkombëtare Penale”**

Në datat 15-16 Dhjetor 2005, në Beograd, Komiteti Suedez i Helsinkit në bashkëpunim me Koalicionin për Gjykatën Ndërkombëtare Penale organizoi një trajnim rajonal për rolin dhe funksionimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Qëllimi i këtij trajnim dy-ditor ishte dhënia e një informacioni të përgjithshëm për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, qëllimin, rolin dhe mënyrën e funksionimit të saj si edhe për të nxitur një bashkëpunim efektiv ndërmjet vendeve të rajonit të ballkanit për krijimin e një koalicionit të përbashkët lidhur me zbatimin e Statutit të kësaj gjykate në legjislacionin e vendeve përkatëse. Në këtë trajnim, KShH-ja u përfaqësua nga Ersida Sefa, juriste, asistente projektsh në KShH.

13. Pjesëmarrja në Aktivitete të Ndryshme

²⁰ Ky trajnim u mundësua nga projekti “Ngritja e kapaciteteve të organizatës dhe forcimi i organizimit të brendshëm”, financuar nga Cordaid

²¹ Ky trajnim u mundësua nga projekti “Ngritja e kapaciteteve të organizatës dhe forcimi i organizimit të brendshëm”, financuar nga Cordaid

²² Ky trajnim u mundësua nga projekti “Ngritja e kapaciteteve të organizatës dhe forcimi i organizimit të brendshëm”, financuar nga Cordaid

- Më 10 Tetor 2005, Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë me ndihmën e Institutit të Studimeve Ndërkombëtare dhe Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung organizoi takimin lidhur me politikën e jashtme të vendit tonë dhe politikën e sigurimit, ku u prezantuan përparësitë e qeverisë shqiptare për këto fusha. Në këtë tryezë mori pjesë E. Papavangjeli, Koordinator Programesh në KShH.
- Më 18 Tetor 2005, Ministria e Integritimit Evropian në bashkëpunim me Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë dhe me mbështetjen e Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ) organizoi Konferencën “Pjesmarrja e Shqipërisë në Programet e Fqinjësisë” në kuadrin e promovimit të Thirrjes për Projekt- Propozime për Programet e Fqinjësisë CADSES, Itali-Adriatik dhe Greqi-Shqipëri. Në këtë tryezë mori pjesë E. Papavangjeli, Koordinator Programesh në KShH.
- Më 20 Tetor 2005, KShH mori pjesë në një tryezë të përbashkët, të organizuar nga një grup përfaqësuesish të shoqërisë civile u mblodhën në një tryezë të përbashkët me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile, sidomos ndërmjet organizatave jofitimprurëse për të thelluar presionin ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut. Në këtë tryezë mori pjesë Në këtë tryezë mori pjesë E.Sefa, Juriste/As.Projekti në KShH.
- Më 27-28 Shtator 2005, u organizua takimi vijues për vlerësimin e zbatimit të Konventës Kuadër “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, organizuar nga Komiteti Këshillimor i Këshillit të Europës. Në këtë takim morën pjesë, znj.V.Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, E.Papavangjeli, koordinatorë programesh në KShH, dhe znj. K.Alikaj, juriste/as.administrative në KShH.
- Më 27 Tetor 2005, IOM-i organizoi takimin e dytë të punës lidhur me hartimin e dokumentit të punës për “Vlerësimin mbi krijimin e qendrës së mbyllur të pritjes për migrantët e parregullt në Shqipëri”, pjesë e të cilit ishte dhe KShH. Ky takim ishte një folloë-up i takimit të parë të punës të mbajtur në Korrik 2005 me përfaqësues të rrjetit të krijuar për këtë qëllim. Në këtë tryezë mori pjesë E.Sefa, Juriste/As.Projekti në KShH.
- Më 4 Nëntor 2005, Unioni “Amaro Drom” organizoi një tryezë të rumbullakët në të cilën u diskutuan problemet e trafikimit të fëmijëve dhe femrave të minoritetit Rom. Në këtë tryezë u përfaqësua edhe KSHH si një organizatë që ka punuar dhe bashkëpunuar me Unionin Amaro Drom për minoritetin Rom. Në këtë tryezë mori pjesë K.Alikaj, juriste/As.administrative në KShH
- Më 17 Nëntor 2005, në Hotel Rogner, Qendra e Aleancës gjinore për zhvillim organizoi një aktivitet për prezantimin e studimit të kryer nga kjo qendër, “Analiza gjinore e teksteve të shkollës fillore”, në të cilin morën pjesë KShH. Në këtë tryezë mori pjesë E. Saliu, juriste/koordinatorë projekti.
- Më 25.11.2005, KShH mori pjesë në tryezën e rumbullakët “Raste të ligjore përgjatë proceseve në gjykatat shqiptare”, organizuar nga Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut. Në këtë tryezë mori pjesë K.Alikaj, Juriste/As.Administrative.
- Më 1 Dhjetor 2005 në Ditën Ndërkombëtare kundër Hiv/Aids Koalicioni për Fëmijët me Hiv/Aids i përbërë nga më tepër se 10 organizata jofitimprurëse organizoi një fushatë kombëtare për këtë kategori fëmijësh me moton “Një jetë më e mirë për fëmijët me Hiv/Aids në Shqipëri”, pjesë e të cilës ishte dhe organizimi i një seance të posaçme dëgjimore për çështjet e fëmijëve të

prekur me Hiv/Aids nga Komisioni Parlamentar i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë. Në këtë tryezë mori pjesë E.Sefa, Juriste/As.Projekti në KShH

- Më 14 dhjetor 2005, KShH mori pjesë në ëorkshopin e organizuar nga UNICEF lidhur me zbatimin e projektit 3-vjeçar për sistemin e drejtësisë për të miturit. Në këtë ëorkshop ishin ftuar aktorët kryesorë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Në këtë tryezë mori pjesë E.Saliu, juriste/koordinatore projekti.
- Më 15 dhjetor 2005, KShH mori pjesë në tryezën e “Çështja e arsimimit të Romëve në vëndin tonë dhe fillimi i zbatimit të strategjisë për minoritetin rom”, organizuar nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur, Soros, Tiranë. Në këtë tryezë mori pjesë E.Papavangjeli, Koordinatore programesh në KShH.
- Më 23 Dhjetor 2005, Unioni i Romëve të Shqipërisë “Amaro – Drom”, organizoi një tryezë të rrumbullakët “Politikat stimuluese për zhvillimin e minoritetit rom në Shqipëri”. Vënd kryesor në këtë tryezë pati zbatimi i strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom në Shqipëri”. Në këtë tryezë mori pjesë E.Sefa, Juriste/As.Projekti në KShH.

Përgatiti për Internet: **av. Etilda SALIU**

Juriste/koordinatore projekti

Për më shumë informacion mund të na kontaktoni në adresën:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr: Gjin Bue Shpata; Pall. 5/1, Ap.4, Tiranë, Kutia postare Nr. 1752

Tel: 04 233671 & 04 229002

Fax: 04 233 671

E-mail: office@ahc.org.al; web site: www.ahc.org.al

ANEKS NR.1 - DEKLARATA

1. Tolerancë ndaj kritikave të gazetarëve

Tiranë, më 24 Tetor 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH-ja), mbasi u njoh me urdhërin e datës 13 Tetor 2005, të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, e vlerëson atë si një masë që do t'i shërbente një transparence më të madhe ndaj kritikave që bëhen nga mediat ose nga gazetarë të veçantë.

Por, lidhur me përmbajtjen e këtij urdhëri, Komiteti Shqiptar i Helsinkit e shikon të nevojshme të evidentojë vetëm atë pjesë që u kërkohet zyrtarëve politikë të mos bëjnë asnjë padi penale ose civile. Ky mund të ishte një rekomandim i kuptueshëm dhe i bazuar, ndërsa urdhërimi nuk na duket i përshtatshëm.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit mendon se një urdhër i tillë kategorik nuk mban parasysh faktin, se edhe zyrtari politik ose funksionari i lartë shtetëror është shtetas që Kushtetuta i garanton të drejtën e ankimit. Në pikën 2 të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thuhet: “Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e pananshme e caktuar me ligj”.

KSHH-ja, edhe në të kaluarën, në rastet kur funksionarë të shtetit kanë paditur në rrugë penale ose civile gazetarë të ndryshëm, ka reaguar publikisht duke bërë thirrje për një tolerancë më të madhe nga ana e zyrtarëve të lartë si edhe ka sugjeruar shqyrtimin objektiv të çështjeve të tilla nga gjykatat përkatëse.

Në këtë drejtim, KSHH-ja ka patur dhe ka parasysh qëndrimin konsenguent të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kështu, për shembull, lidhur me çështjen e gazetarit Ligens kundër Austrisë, Gjykata e mësipërme në vendimin e saj është shprehur se: “Kufijtë e lejueshme të kritikës janë më të gjerë ndaj politikanëve dhe ndaj veprimeve të tyre politike sesa ndaj personave privatë”. Dhe më poshtë: “Politikanët me dashje dhe në mënyrë të pashmangshme ekspozohen ndaj reagimit që zgjon çdo fjalë e tyre dhe për gjithçka që bëjnë sot, madje edhe për atë që kanë bërë në të kaluarën. Por, ata duhet medoemos të jenë më tolerantë, madje edhe ndaj sulmeve brutale”.

Megjithëkëtë, po në këtë vendim Gjykata thekson se: “Kjo, natyrisht nuk do të thotë se dikush, meqënëse është person publik mund të nëpërkëmbet pa u dënuar, madje pa e patur edhe mundësinë për të mbrojtur emrin e tij të mirë (reputacionin e tij)”. (*Shih librin “Gurët udhërrëfytes”, botim i vitit 2000, përkthim shqip, faqe 411-412*).

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, e shikon të nevojshme të përmendë gjithashtu se vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut përbëjnë precedent të detyrueshëm edhe për vendin tonë, shtet anëtarë që ka ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në përfundim, KSHH-ja sugjeron diskutimin dhe miratimin e shpejtë të projekt-ligjit “Për lirinë e shtypit” dhe në këtë frymë sygjeron rishikimin edhe të dispozitave përkatëse të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë drejtim, do të mjaftonte të përmendej fakti se, sipas pikës 3 të nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale, kur të dhënat për të vërtetuar veprën penale janë të domosdoshme, gjykata mund të urdhërojë gazetarin të tregojë burimin e informacionit të tij.

KSHH-ja shpreh me këtë rast, vlerësimet e veçanta për rolin e shtypit në drejtim të intesifikimit të luftës kundër korrupsionit.

KSHH-ja shpreson në mirëkuptimin e çdo gazetari lidhur me përmbajtjen e kësaj deklaratë.

2. Njoftim për shtyp – ENERGJIA ELEKTRIKE

Tiranë, më 16 Nëntor 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit konstaton se megjithë masat e marra, kriza energjetike që ka përfshirë gjithë vendin, vazhdon të jetë serioze, tepër shqetësuese me pasoja të rënda dhe të ndjeshme në dëm të interesave të ligjshme të shtetasve dhe të ekonomisë në tërësi.

Njerëzit nuk janë të qartë sa kohë do të vazhdojë kjo gjendje dhe cila do të jetë zgjidhja e saj në të ardhmen.

KSHH në këtë reagim publik mbështetet jo vetëm në të dhënat e shtypit, por edhe nga vëzhgimet në vend. Ne konstatojmë gjithashtu se deklaratat e ditëve të fundit për një kufizim të reduktuar deri në 40 përqind të energjisë elektrike nuk konkretizohen në praktikë si në Tiranë dhe atë më keq në qytetet e tjera dhe zonat urbane.

Është kjo arsyeja që KSHH e shikon me vend t'i bëjë thirrje qeverisë dhe në mënyrë të veçantë drejtuesve të KESH-it që pavarësisht nga vështirësitë objektive, të jenë me transparente ndaj shtetasve kur bëjnë deklaratat ose kur shpallin oraret e kufizimeve.

Në takimet që KSHH ka patur me shtetas të shtresave të ndryshme, studentë, pedagogë, punonjës të shëndetësisë, biznesmenë, etj., ka arritur në përfundimin se aktualisht atyre pak u intereson se kush mban përgjegjësi për gjendjen e krijuar. Ata duan drita, kërkojnë përmirësimin e situatës, ndërsa fajtorët, kushdo qofshin ata vihen para përgjegjësisë ligjore.

KSHH-ja, megjithëse vlerëson përpjekjet që po bëhen për zbutjen e kësaj krize, sugjeron masa më të efektshme për kapërcimin e saj brenda një kohe sa më të shkurtër.

3. Gjykatat greke kanë shansin të dëshmojnë efektivitetin e tyre në luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë

Tiranë, më 23 Nëntor 2005

Në datën 25 nëntor 2005, në Patra të Greqisë do të zhvillohet gjyqi penal lidhur me vrasjen e emigrantit shqiptar Gramoz Palushi.

Një vit më parë, më datë 4 shtator 2004, emigranti shqiptar Gramoz Palushi është goditur në mënyrë vdekje prurëse nga një shtetas grek në ishullin Zakyntho të Greqisë. Ngjarja ndodhi ditën e fitores së skuadrës shqiptare në ndeshjen e futbollit Shqipëri-Greqi. Sulmi vdekjeprurës u krye vetëm sepse emigranti shqiptar Gramoz Palushi demonstroi gëzimin e tij për fitoren e ekipit shqiptar në një ndeshje futbolli duke shpalosur flamurin kombëtar.

Opinionin publik, media shqiptare dhe greke, autoritetet shtetërore të të dy vendeve dënuan ashpër këtë akt barbar, shprehje e ksenofobisë dhe racizmit. Komiteti Shqiptar i Helsinkit me anë të deklaratës së tij publike të datës 6 shtator 2004 ka reaguar ndaj këtij akti dhe i ka kërkuar autoriteteve greke marrjen e masave përkatëse për vënien e fajtorëve para përgjegjësisë ligjore.

Duke ndjekur ecurinë e hetimeve mbi vrasjen e emigrantit shqiptar, Komiteti Shqiptar i Helsinkit së bashku me Monitorin Grek të Helsinkit, në shkurt të vitit 2005, kanë shprehur shqetësimin në një konferencë të përbashkët për shtyp duke theksuar se “hetimi i rastit të Gramoz Palushit të vrarë nga një racist pas ndeshjes së futbollit Shqipëri-Greqi në shtator 2004 duket se ka gjetur një vlerësim “komod” psikiatrik të autorit të krimit, ç’ka është shkencërisht e gabuar”.

Sot pas një vit, në prag të fillimit të procesit gjyqësor ndaj autorit të këtij krimi makabër:

- Duke besuar në vlerat e një vendi demokratik, anëtare e Bashkimit Europian siç është Greqia;
- Duke theksuar rëndësinë që ka respektimi i parimeve të sanksionuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut të ratifikuar nga Greqia lidhur me zhvillimin e një procesi të rregullt dhe ligjor;
- Duke vlerësuar rëndësinë e pavarësisë së sistemit gjyqësor në vendet demokratike;
- Duke vlerësuar rëndësinë e luftës kundër shprehjeve të ksenofobisë dhe të racizmit në Europë në përgjithësi dhe në Greqi, në veçanti;
- Duke vlerësuar nevojën e bashkëpunimit dhe frymën e miqësisë që ekziston midis vendeve fqinje;
- Duke vlerësuar rëndësinë e respektimit të të drejtave të viktimave;
- Duke sjellë në vëmendje e autoriteteve gjyqësore greke përfundimet e institucioneve ndërkombëtare monitoruese si ECRI i cili në raportin e tij të tretë për Greqinë, të bërë public në korrik 2004 thekson se “ECRI i rekomandon autoriteteve greke të forcojnë dispozitat ligjore dhe

zbatimin e tyre në ligjet penale, civile dhe administrative me qëllim që të luftojnë racizmin dhe diskriminimin dhe "të rrisin përpjekjet për të ndërgjegjësuar punonjësit civile, publikun në tërësi dhe media rreth të drejtave të njeriut dhe problemeve të racizmit dhe intolereancës".

Komiteti Shqiptar i Helsinkit beson se:

1. Autoriteteve gjyqësore greke do të zhvillojnë një proces të rregullt gjyqësor, të paanshëm dhe objektiv kundër autorit të krimit që mori jetën e emigrantit shqiptar Gramoz Palushi;
2. Se drejtësia greke në zbatimin e politikës penale do të mbajë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe autorit dhe pasojat e rënda të ardhura nga vepra kriminale e kryer;
3. Se gjykata greke do ta mbajë parasysh motivet raciste, teje të rënda për të cilat u krye vepra penale;
4. Se interesat e viktimës do të vlerësohet në përputhje me standartet Europiane lidhur trajtimin dhe dëmshpërblimin e viktimave.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit rithekson edhe një herë idenë se aktet e dhunshme, të ksenofobisë dhe të racizmit çënojnë rëndë atmosferën e shëndoshë midis popujve tanë.

Drejtësia greke ka shansin të tregojë se ajo është e vendosur të dënojë ashpër çdo shfaqje racizmi dhe intolerance, e kryer nga kushdo qoftë.

4. PROBLEM QË KËRKON ZGJIDHJE URGJENTE

Tiranë më 2 Dhjetor 2005

Ka disa ditë që në median e shkruar dhe në atë elektronike jepen njoftime për shqetësimin që u është krijuar pensionistëve, invalidëve dhe veteranëve lidhur me mostërheqjen e barnave me rimbursim në bazë të recetave mjekësore. Komiteti Shqiptar i Helsinkit e ka ndjekur nga afër këtë problem. Ai ka dëgjuar edhe ankesat e disa shtetasve. KSHH është njohur gjithashtu edhe me pretendimet e farmacistëve se Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor nuk ka kaluar në favorin e tyre shuma të konsiderueshme, vlerë e recetave të rimbursuara.

Fakti që Instituti i Kujdesit Shëndetësor rezulton me një defiçit (borxh financiar) të llogaritur me miliona dollarë, nuk mund të justifikojë sorollatjen dhe mossigurimin me barnat e nevojshme të rimbursuara, të shtetasve që ligjërisht e gëzojnë këtë të drejtë.

KSHH mendon se abuzimet e ndryshme që në këtë drejtim mund të jenë kryer nga zyrtarë, mjekë, farmacistë apo pacientë të veçantë, nuk mund të justifikojnë gjithashtu vonesat në zgjidhjen e këtij problemi kur dihet se kjo rëndon shëndetin e një shtrese të gjerë të popullatës që janë në nevojë.

Është kjo arsyeja që KSHH i bën thirrje qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave dhe Institutit të Kujdesit Shëndetësor që krahas masave për vënien para përgjegjësisë ligjore të personave shkaktarë të kësaj gjendjeje, të urdhërojnë zbatimin me rigorozitet të akteve ligjore që garantojnë rimbursimin e barnave për kategori të caktuar të shtetasve. Në të kundërtën, çdo zvarritje ose neglizhencë do të dëmtonte interesat e ligjshme të shtetasve dhe si rrjedhim shëndetin e tyre.

5. ZVARRITJE ME PASOJA

Tiranë, më 6 dhjetor 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut dhe Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut bashkohen me shqetësimin e një pjese të qytetarëve të Tiranës se në disa rrugë të bllokua, siç janë kalimi tek "Zogu i Zi" në rrugën e Elbasanit etj, po hasin në vështirësi të mëdha kalimi sidomos tani në stinën e dimrit. Pikërisht, për këtë shkak është rënduar së tepërmi edhe trafiku i makinave gjë që mund të

shoqërohet me pasoja të dëmshme. Është për të ardhur keq se në vend që kësaj situate t'i jepet fund, zëdhënësi i Ministrisë së Transporteve dhe ai i Bashkisë së Tiranës organizojnë konferenca shtypi ku jepen deklarata me akuza të ndërsjellta.

Deklarata të tilla nuk i shërbejnë qetësismit të qytetarëve, përkundrazi tek ata krijohet indinjatë dhe zemërim.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut dhe Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut mendojnë se organet përkatëse shtetërore duhet të jenë transparente ndaj shtetasve. T'u thuhet atyre qartë dhe prerë se çfarë është vendosur. Do të anulohen punimet e filluara apo ato do të zhblokohen dhe kur.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut dhe Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut mbështetin qëndrimet dhe veprimet për zbatimin rigoroz të ligjit dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, por në rastin konkret, kjo nuk justifikon zvarritjen pa fund të problemit. Në fund të fundit, vetë pezullimi është një masë e përkohshme, por edhe në raste të tilla, pasojat duhet të parandalohen, të reduktohen.

Le të vihen para përgjegjësisë ligjore cilido që ka shkelur ligjin, por shtetasit nuk mund të qëndrojnë në pritje derisa të gjendet fajtori.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut
Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut

6. TË ZBULOHEN ME PREÇEDENCË AUTORËT E DHUNIMIT TË GAZETARIT

Tiranë, më 13 Dhjetor 2005

Sipas njoftimeve të shtypit, korrespondenti i disa mediave Z. Engjëllush Serjani është goditur në mënyrë të papritur nga disa persona të panjohur duke i shkakuar atij lëndime. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, duke patur parasysh cilësinë e tij si gazetar, pavarësisht se ende nuk janë zbardhur motivet e këtij akti, u sugjeron organeve përkatëse që të zhvillojnë hetime të plota dhe me preçedencë.

KSHH e shikon të nevojshme të përmendë se nuk është rasti i parë i keqajtimit të gazetarëve. KSHH ka parasysh gjithashtu se mbrojtja e ligjshme e gazetarëve ka të bëjë me mbrojtjen e fjalës së lirë, të inkurajimit të kritikës dhe transparencës.

7. Akt kriminal me rrezikshmëri të theksuar shoqërore

Tiranë, më 19 Dhjetor 2005

Sipas njoftimeve të shtypit në mbrëmjen e datës 18 Dhjetor 2005, rreth orës 21:30, në ballkonin e katit të parë të godinës ku ndodhet redaksia e gazetës "Shekulli" në rrugën "Don Bosko" Tiranë, persona të panjohur kanë hedhur lëndë eksplozive.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e dënon fuqishëm këtë akt të rëndë, të rrezikshëm dhe banditesk që rrezikon jetën e njerëzve, të gazetarëve të kësaj redaksie.

KSHH, edhe pse çështja penale ka filluar, u sugjeron organeve përkatëse ta ndjekin atë me përparësi, të zbulojnë dhe të vënë para përgjegjësisë penale autorët e këtij krimi.

KSHH, ashtu si edhe më parë, ka dënuar aktet e dhunshme ndaj gazetarëve në të gjitha format që ato janë shprehur. Në një shoqëri siç jemi edhe ne, media e shkruar dhe ajo elektronike luajnë një rol të rëndësishëm edukativ, sensibilizues dhe parandalues të së keqes.

KSHH konstaton me kënaqësi se shtypi tek ne çdo ditë dhe më shumë merr tiparet e një mjete të pazëvendësueshëm që karakterizohet nga transparenca dhe guximi në shërbim të një opionence konstruktive.

Edhe pse nuk dihen motivet e vërteta të kësaj ngjarjeje tronditëse dhe me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, KSHH është i bindur se akte të tilla direkt ose indirekt drejtohen kundër shtypit të lirë.

KSHH shpreh me këtë rast kënaqësinë e vet që rastësisht akti i mësipërm nuk u shoqërua me dëmtimin e shëndetit dhe jetës së gazetarëve.

KSHH bashkohet me shqetësimin e gazetarëve të “Shekullit” dhe u uron atyre që edhe në të ardhmen të përmbushin me dinjitet misionin e tyre sa të rëndësishëm aq edhe të dobishëm.

8. FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORES EKZEKUTIVE TË KSHH-SË NË CEREMONINË E 15 – VJETORIT TË KSHH-SË

19 Dhjetor 2005

Të nderuar pjesëmarrës,

Menjëherë pas themelimit të Partisë Demokratike, më 19 Dhjetor 1990, u krijua “Forumi për të drejtat e njeriut”, organizata e parë jo-qeveritare, jopartiake dhe e pavarur. Ishte merita e disa intelektualëve tanë që e morën këtë nismë aq të domosdoshme në kushtet pas përmbysjes së regjimit totalitarist.

Dokumenti ose akti i parë publik i kësaj organizate ishte thirrja për lirim e të dënuarve dhe të internuarve për motive politike.

Qysh në fillim, Forumi i të Drejtave të Njeriut gjeti mbështetjen dhe inkurajimin e opinionit të gjerë shoqëror. Veprimtaria e tij pati jehonë edhe në botën demokratike. Ai u përshëndet sidomos nga organizatat e tjera simotra jo-qeveritare që vepronin në të njëjtën fushë. Kjo ishte edhe arsyeja që në Mars të vitit 1992, Forumi Shqiptar, u pranua si anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe u emërtua Komiteti Shqiptar i Helsinkit. KSHH vepron në bazë të statutit. Misioni i tij kryesor ishte dhe mbetet mbrojtja e lirisë dhe të drejtave të ligjshme të shtetasve që sanksionohen në dokumentat ndërkombëtarë dhe legjisllacionin tonë të brendshëm, kryesisht në dispozitat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Nuk ka qenë e lehtë që KSHH-ja të krijonte besimin tek njerëzit. Për këtë duheshin veprime konkrete, të ekuilibruara, të paanshme dhe të guximshme.

Në këto 15 vjet, KSHH-ja është ndeshur edhe me pengesa, edhe me reagime negative në adresë të tij, edhe me sulme denigruese. Ka patur raste që opionenca konstruktive nuk është kuptuar drejt nga organet shtetërore, madje pjesërisht edhe nga ndonjë media e shkruar. Megjithatë, asnjëherë KSHH nuk është tërhequr, nuk është ndikuar nga politika, pavarësisht nga rotacionet e pushtetit.

KSHH-ja nuk ka pretenduar dhe nuk pretendon të mbulojë të gjitha fushat ku vepron legjisllacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të shtetasve. Si fushë prioritare për KSHH-në kanë qenë dhe mbeten vëzhgimet e zgjedhjeve periodike, respektimi i të drejtave të të dënuarve dhe të paramburgosurve, respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare, aspekte të veçanta të respektimit të drejtave të shtetasve në sistemin gjyqësor, etj.

Organi vendimarrës i KSHH-së është mbledhja e përgjithshme e tij që zgjedh bordin dhe drejtorin ekzekutiv. Me një staf administrativ prej pesë personash aktiviteti do të ishte shumë i kufizuar. Në qoftë se

KSHH-ja ka arritur disa rezultate modeste në punën e tij, janë aktivistët e shumtë të tij, të rinj dhe të reja, studentë, intelektualë dhe specialistë të fushave të ndryshme që kryesisht, në mënyrë vullnetare, janë angazhuar në zbatimin e projekteve.

Në metodologjinë e punës së KSHH-së bëjnë pjesë reagimet publike, ndërhyrjet e formave të ndryshme në përputhje me ligjin, botimi i raporteve periodike, organizimi i seminareve dhe tryezave të rrumbullakëta, etj.

KSHH, edhe pse konstaton shkelje dhe arbitraritete, nuk praktikon dhe nuk do të praktikojë organizimin ose nxitjen e tubimeve dhe protestave publike. Ai qëndron larg aktiviteteve politike. Në këtë vështrim, KSHH ka qenë dhe mbetet i hapur për të bashkëpunuar edhe me organizatat e tjera jo-fitimprurëse, duke respektuar specifikën e çdo organizate të sanksionuar në statutet e tyre.

KSHH, duke bërë bilancin e aktivitetit të tij 15 vjeçar, konstaton me kënaqësi se tek ne janë bërë hapa të ndjeshme përpara në fushën e respektimit të lirive dhe të drejtave të shtetasve. Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se edhe konceptet mbi rolin e OJF-ve në një shoqëri demokratike kanë ndryshuar.

Ne vëmë re me kënaqësi se bashkëpunimi i KSHH-së me organet shtetërore duke përfshirë këtu edhe parlamentin dhe sidomos komisionet e ligjeve, të rendit dhe SHISH-it, të të drejtave të njeriut ka qenë i mirë.

Oponencat ligjore të KSHH-së lidhur me disa projektligje të rëndësishme janë vlerësuar, madje në mjaft raste janë marrë parasysh. Ne do të dëshironim që ky bashkëpunim të vazhdonte edhe në të ardhmen.

Megjithatë, KSHH mendon se në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut ka ende shumë për të bërë. E themi këtë edhe për faktin se ky është një tregues i rëndësishëm dhe i ndjeshëm, element i domosdoshëm për integrimin e vendit tonë në familjen e madhe Evropiane.

Në përfundim, më lejoni që në emër të KSHH-së të falenderoj të gjithë pjesëmarrësit në këtë përvjetor, aktivistët e shumtë të KSHH-së, në mënyrë të veçantë themeluesit e Forumit të të Drejtave të Njeriut, të gjithë ata shtetas që me sinjalizimet dhe ankimet e tyre na kanë vënë në lëvizje, por edhe ata që na kanë kritikuar me dëshirën e mirë për gjallërimin e mëtejshëm të veprimtarisë së KSHH-së.

Në emër të KSHH-së gjej rastin të falenderoj donatorët e huaj që kanë vlerësuar punën e KSHH-së dhe e kanë mbështetur atë jo vetëm financiarisht, por edhe me asistencën e herëpashershme për ngritjen cilësore të aktiviteteve të ndryshme të KSHH-së në zbatim të praktikave më të efektshme bashkëkohore.

Më lejoni gjithashtu që me këtë rast të falenderoj përfaqësuesit e medias së shkruar dhe elektronike që herë pas here na kanë dhënë mundësinë e publikimit të deklaratave ose prononcimeve publike në të cilat është pasqyruar qëndrimi i KSHH-së.